



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

KOLEGJI HEIMERER
RAPORT I MONITORIMIT

11.05.2023, Prishtinë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

1. HYRJE

Zyrtarët përgjegjës të AKA-së për procedurën:

- *Naim Gashi, Drejtor i AKA-s;*
- *Leona Kovaçi, ZL për Monitorim dhe Vlerësim;*
- *Mirlinda Xhylani, Praktikante.*

Data e fillimit të procedurës së monitorimit: 11.05.2023

Monitorimi është realizuar: a) në distancë
b) me vizitë në terren me paralajmërim
c) me vizitë në terren pa paralajmërim

Data e vizitës monitoruese (nëse aplikohet): 11.05.2022

Personat me të cilët zyrtarët e AKA-së janë takuar në vizitën në terren (nëse aplikohet):

- *Linda Ukimeraj Harris – Koordinatore për sigurim të cilësisë;*
- *Kaltrina Azizi, prof. Asistente.*

Burimet e informimit për raportin e monitorimit:

- *Web faqja e Kolegjit Heimerer;*
- *Panoja e publikuar për studentë;*
- *Intervista me koordinatore dhe asistente.*



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

2. Përshkrim i shkurtë i zhvillimit të procedurës së monitorimit për verifikimin e orarit të ligjëratave dhe ushtrimeve, përfshirë të dhënat në rend kronologjik (nëse aplikohen):

Vizita monitoruese në Kolegjin Heimerer filloi në orën 14:00.

Vizita e realizuar në Kolegjin Heimerer ka filluar me monitorimin e orarit në ueb faqe të Kolegjit, në të cilin janë të publikuara oraret për programet e studimit. Ekipi i AKA me arritje në institucion kanë njoftuar koordinatoren e kolegjit që t'i bashkëngjitet ekipit për t'i shoqëruar gjatë vizitës monitoruese në institucion. Ekipi i AKA-s ka verifikuar panon informuese për student në hapësirat e përbashkëta të institucionit si dhe bashkë me koordinatoren e kolegjit ka kërkuar të vizitohen klasat në të cilat mbahen ligjëratat dhe në ato të cilat mbahet puna praktike apo vendi i mbajtjes së punës praktike.

Orari i paraqitur i mësimit ka qenë për programin e studimit në Infermieri BSc, në sallën numër 301 me mësimdhënësin prof. Bernard Tahirbegolli.

Me të arritur te salla 301, ajo ka qenë e zbrazët dhe stafi i kolegjit njoftoj ekipin monitorues se është duke u mbajtur Java e Infermierisë dhe se aktualisht është duke u zhvilluar një konferencë mbi Infermierinë, dhe se orari i mësimëve ka ndryshuar për shkak të aktiviteteve ekstra kurrikulare. Ekipi i monitorues ka verifikuar edhe aktivitetet e realizuara lidhur me konferencën e infermierisë e cila po vijonte brenda hapësirave të Kolegjit Heimerer.

Në bashkëbisedim e sipër, ekipi monitorues kërkoi nga koordinatoresha e kolegjit dhe zyrtarët përgjegjës:

- Dëshmi mbi oraret e mbajtjes së praktikës me student, si dhe marrëveshjet dhe informata se në cilat institucione mbahet puna praktike.

Koordinatorja nga Kolegji Heimerer ka ofruar dëshmi mbi mbajtjen e praktikës si në vijim:

- Kolegji Heimerer kishte Marrëveshje Bashkëpunimi me QKUK për vijimin e praktikës së studentëve të këtij kolegji, sipas orarit prej orës 15 deri në 20.
- Ndërsa në klinikat private me të cilat kolegji ka Marrëveshje Bashkëpunimi, studentëve ju mundësohet praktika nga ora 08 – 15.

Kolegji Heimerer ka njoftuar AKA-n se kanë bërë kërkesë që orari i praktikës ka nevojë të ndryshohet si dhe ka dhënë si dëshmi kopje të kërkesës.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

Gjatë këtij takimi ekipi i monitorues është njoftuar se si pjesë e punës praktike si dhe javës së infermierisë, kolegji do të realizoj një aktivitet simulimi në rast të alarmit të zjarrit, ku ekipi monitorues ka qenë i pranishëm. Në këtë aktivitet, fillimisht ka rënë alarmi i zjarrit, është zbrazur ndërtesa, kanë ndërhyrë ekipet e zjarrfikësve si dhe ndihma e shpejtë, ku është simuluar një lëndim dhe dhënia e ndihmës së parë në rast të lëndimit.

3. VLERËSIMI PËRFUNDIMTAR

1. Ueb faqja e Kolegjit Heimerer, ka pasur mungesë të disa informatave lidhur me oraret për semestrin verorë dhe pjesën e punës praktike.

4. SHTOJCAT (dokumentet e mbledhura gjatë vizitës)

1. Orari i ligjeratave dhe ushtrimeve për vitin akademik 22/23;
2. Orari i punës praktike në QKUK dhe klinika publike dhe private tjera;
3. Marrëveshje bashkëpunimi në mes K. Heimerer dhe QKUK;

Zyrtarët për Vlerësim dhe Monitorim të AKA-së

Kryesues

NAIM GASHI [Signature]
(Emri dhe Mbiemri) (Nënshkrimi) (Data)

Anëtar

Leona Levori [Signature]
(Emri dhe Mbiemri) (Nënshkrimi) (Data)

Anëtar

Virionde Gashi - Xhylomi [Signature]
(Emri dhe Mbiemri) (Nënshkrimi) (Data)